

Banka Popullore e Republikës së Maqedonisë së Veriut

DREJTORIA PËR POLITIKË MONETARE DHE HULUMTIM



Treguesit më të rinj makroekonomik Pasqyrë e gjendjes aktuale

dhjetor 2023

Treguesit më të rinj makroekonomik

Pasqyrë e gjendjes aktuale – ndikimet mbi politikën monetare

Pasqyra e gjendjes aktuale ka për qëllim të japë rishikimin e të dhënave më reja makroekonomike (shtator 2023 - nëntor 2023) dhe krahasim me parashikimet e fundit makroekonomike (tetor 2023). Me atë do të përcaktohet se sa gjendja aktuale në ekonominë korrespondon me lëvizjet e pritshme të variablave në ciklin e fundit të parashikimeve. Pasqyra është fokusuar në ndryshimet e supozimeve dhe realizimeve të jashtme të variablave të brendshme dhe në atë se si këto ndryshime reflektohen mbi ambientin për zhvillimin e politikës monetare.

Shikimet e fundit¹ për rritjen e ardhshme ekonomike globale janë të ngjashme me atë të tetorit, me ç'rast edhe më tej pritet ngadalësim gradual i rritjes në vitin 2023 dhe 2024 dhe përsheptim të moderuar në vitin 2025. Rreziqet janë kryesisht ende në rënie dhe lidhen kryesisht me efektet e shtrëngimit të deritanishëm të politikës monetare në mbarë botën dhe mbajtjen eventuale të normave të larta të interesit për periudhë më të gjatë. Rreziqet tjera i referohen rritjeve të tensioneve gjeopolitike (kryesisht të lidhura me konfliktin ushtarak Izrael-Gaza), kufizimet e mëtejshme tregtare, si dhe rritja eventuale më e dobët e Kinës dhe efektet nga ndryshimet klimatike.

Shikuar përmes treguesve të veçantë sasior për mjedisin e jashtëm të rëndësishme për ekonominë maqedonase për periudhën 2023-2025, vlerësimet për kërkesën e huaj efektive janë pothuajse të pandryshuara, ndërsa tek inflacioni efektiv i huaj ka rishikime më të larta minimale për vitin 2023 dhe 2024 në krahasim me parashikimet e tetorit. Lidhur me kursin e këmbimit, pritet edhe më tej zhvlerësim i dollarit amerikan në raport me euron, por mesatarisht më pak në krahasim me vlerësimet e muajit tetor. Rishikimet e çmimeve botërore të produkteve primare janë në drejtim të ndryshëm, por ende pritet rënie të çmimeve në vitin 2023 dhe 2024 dhe kryesisht stabilizim në vitin 2025. Megjithatë, lëvizjet dhe vlerësimet e çmimeve të produkteve primare janë jashtëzakonisht të ndryshueshme dhe nën ndikim të fuqishëm të zhvillimeve që lidhen me luftën në Ukrainë dhe konfliktin ushtarak në Lindjen e Mesme, që krijon pasiguri të madhe rreth dinamikës dhe efekteve të tyre të ardhshme në ekonominë globale dhe të brendshme.

Lidhur me vlerësimet e politikës monetare të ardhshme të BQE-së, parashikimet e reja për **normën e huaj të interesit EURIBOR** me maturim një muaj për vitet 2023 dhe 2024 janë rishikuar pak më lartë ndërsa në rënie për vitin 2025, në pajtim me pritjet e tregut për ulje të normave të interesit në gjysmën e dytë të vitit të ardhshëm, në kushtet e ngadalësimit më të fuqishëm të normës së inflacionit. Kështu, BQE-ja në mbledhje në dhjetor, miratoi vendim për ruajtjen e normave të interesit, me vlerësime për ngadalësim të vazhdueshëm të inflacionit në vitin e ardhshëm dhe arritjen e objektivit afatmesëm të inflacionit në vitin 2025. Në të vërtetë, sipas parashikimeve të dhjetorit, pritet që në vitin 2023 norma e inflacionit të arrijë në 5,4% dhe më pas do të ngadalësohet dhe do të arrin 2,7%, 2,1% dhe 1,9% në vitin 2024, 2025 dhe 2026, respektivisht, që është rishikim në rënie për vitin 2023 dhe veçanërisht për vitin 2024². Lidhur me parashikimet e rritjes ekonomike, ato janë rishikuar në rënie për vitin 2023 dhe 2024, me pritshmëri për rritje prej 0,6% dhe 0,8%, respektivisht, pas së cilës pritet rimëkëmbje e ekonomisë së eurozonës me normë të rritjes prej 1,5% në vitin 2025 dhe 2026³.

Treguesit e rinj nga ekonomia vendase i referohen pasqyrës makroekonomike që është kryesisht në pajtim me parashikimet e tetorit. Në tremujorin e tretë të vitit 2023 rritja

¹ OECD pasqyrë ekonomike, nëntor 2023.

² Në shtator u parashikuan normat e inflacionit prej 5,6%, 3,2% dhe 2,1% në vitin 2023, 2024 dhe 2025, respektivisht.

³ Në parashikimet e shtatorit, rritja e parashikuar e PBB-së ishte 0,7% në 2023 dhe 1,1% dhe 1,5% në 2024 dhe 2025, respektivisht.

reale e PBB-së është 1,2% me bazë vjetore (pas rritjes prej 1,1% në tremujorin e mëparshëm), me rritje minimale në bazë tremujore (sipas të dhënave sezonale dhe kalendarike të përshtatura të ESHS-së.). Realizimet janë në linjë me rritjen e parashikuar për këtë tremujor nga cikli i parashikimeve të tetorit. Analizuar sipas komponentëve, rritja është lëvizëse nga eksporti neto, i rimbushur me rritjen e mëtejshme solide dhe nga konsumi personal. Të dhënat me frekuencë të lartë për tremujorin e katërt të vitit 2023 të disponueshme aktualisht janë të kufizuara. Deri tani, të dhënat e muajit tetor tregojnë lëvizje solide pozitive në prodhimin industrial, si dhe ngadalësim të rënies reale tek qarkullimi në totalin e tregtisë. **Në nëntor të vitit 2023, norma vjetore e inflacionit vazhdoi të ngadalësohet dhe u reduktua në 3,1%** (3,5% në muajin e kaluar), që është pak më e ulët se norma e parashikuar nga cikli i parashikimit të tetorit, si rezultat i devijimit të çmimeve të ushqimit dhe energjisë. Në kushtet të shterimit të plotë të presionit nga komponenti ushqimorë dhe energjetikë, norma vjetore e inflacionit është kryesisht në lëvizje nga komponenti bazë e cila gjithashtu ngadalësohet. **Pritshmëritë e konsumatorëve** të dhënë në anketat e nëntorit për lëvizjen e çmimeve në periudhën e ardhshme janë gjithashtu më të favorshme krahasuar me muajin tetor. Gjithashtu, **diferenca në raport me inflacionin e eurozonës** vazhdoi të reduktohet dhe u ngushtua ndjeshëm në tetor, me ngadalësim më të theksuar të inflacionit të brendshëm në raport me atë të eurozonës. Pasiguria e kohëzgjatjes dhe efektit përfundimtar nga masat e përkohshme mbi çmimet vendase të ushqimit, si dhe të dinamikës së ardhshme të çmimeve të produkteve primare të bursës është ende e pranishme dhe e lartë.

Rezervat valutore në fund të nëntorit 2023 arrijnë 3.963.7 milionë euro. Analiza e treguesve të mjaftueshmërisë së rezervave valutore tregon se ato vazhdojnë të mbahen në zonën e sigurt. Të dhënat për shkëmbimin e tregtisë së jashtme në tetor 2023 tani tregojnë për një deficit tregtar më të ulët për tremujorin e fundit të vitit sesa pritej sipas parashikimit të tetorit, por periudha e vlerësimit është shumë e shkurtër që të mund të performohen përfundime më të sakta. Të dhënat për veprimtarinë e këmbimit përfundimisht në fund të nëntorit 2023 tregojnë për hyrje neto nga transfertat private, të cilat janë pak më të larta se sa pritej për tremujorin e katërt, sipas parashikimit të tetorit. Suficiti i realizuar në llogarinë rrjedhëse të bilancit të pagesave në tremujorin e tretë të vitit 2023, si dhe daljet financiare neto të realizuara, janë në linjë me pritjet sipas parashikimit të tetorit.

Lidhur me **lëvizjet në sektorin monetar**, totali i **depozitave** në tetor të vitit 2023 janë më të larta për 8,3% me bazë vjetore, me rritje vjetore të parashikuar për tremujorin e katërt prej 8,4% sipas parashikimit të tetorit. Rritja e **kredisë totale** e sektorit privat në tetor 2023 u ngadalësua duke u reduktuar në 5,3% , që është në kuadër të rritjes prej 5,7% i parashikuar për tremujorin e katërt, sipas parashikimit të tetorit. Sipas të dhënave nga anketat për aktivitetin kreditor për tremujorin e tretë të vitit 2023 tregojnë për shtrëngim të caktuar të kushteve nga aspekti i ofertës së kredive në të dy sektorët, gjatë rënies së kërkesës. Njëkohësisht, rritja e kredive të reja të miratuara është ulur, veçanërisht në kreditimin e sektorit korporativ. Domethënë, shuma e totalit të kredive të reja të miratuara në sektorin privat në 12 muajt e fundit përfundimisht me tetorin, mesatarisht është më e ulët në bazë vjetore.

Në Buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në periudhën janar-tetor 2023 është realizuar deficit prej 25.059 milionë denarë, ose 58,6% nga deficiti i planifikuar për vitin 2023. Deficiti buxhetor financohet nëpërmjet ngarkimit neto të shtetit në tregun e brendshëm dhe nga mjetet e depozitave të shtetit tek Banka Popullore, gjatë kthimit të borxhit neto të shtetit jashtë vendit gjatë kësaj periudhe.

Të dhënat e reja për treguesit kryesorë makroekonomik lëvizin në përgjithësi në pajtim me pritjet. Inflacioni i brendshëm në nëntor 2023 ka vazhduar të ngadalësohet me bazë vjetore, me intensitet pak më të fuqishëm se sa pritej, dhe më të moderuara janë gjithashtu pritjet inflacioniste. Megjithatë, inflacioni mesatar është ende në nivel relativisht të lartë, krahasuar me mesataren historike. Çmimet e produkteve primare në bursë, kryesisht të ushqimit, vazhdojnë të ndjekin rrugë të përshtatjes së ndjeshme rënëse, por megjithatë, transmetimi i rënies tek këto çmime


mbi çmimet vendase zhvillohet më ngadalë dhe me intensitet më të dobët. Edhe pse pritet ulje e mëtejshme e tyre, pasiguria e dinamikës së ardhshme të çmimeve të produkteve primare në bursë është ende e pranishme për shkak të konflikteve aktuale ushtarake. Në tremujorin e tretë të vitit 2023, rritja ekonomike vazhdoi me dinamikë të ngjashme vjetore, e cila është në linjë me pritjet. Të dhënat e disponueshme të frekuencës së lartë për tremujorin e fundit të vitit janë të kufizuara, por arritjet e tetorit në prodhimin industrial dhe tregtinë tani për tani janë në shtojcë të pritjeve për dinamikë më të fuqishme të rritjes ekonomike në këtë periudhë. Lëvizjet në tregun valutor janë të favorshme, me hyrje të mëtejshme të lartë të valutave në tregun e këmbimit, që ndikon në mënyrë të favorshme edhe në rezervat valutore. Gjithashtu, depozitat dhe kreditë aktualisht po lëvizin në kuadër të pritshmërive për tremujorin e fundit të vitit.

Rritja e aktivitetit ekonomik vazhdon edhe në tremujorin e tretë të vitit 2023

Në tremujorin e tretë të vitit, ekonomia e brendshme shënoi rritje reale prej 1,2% me bazë vjetore, që është në linjë me rritjen e pritshme për këtë tremujor nga cikli i parashikimeve të tetorit. Rritja në tërësi vjen si pasojë e kontributit pozitiv të eksportit neto të mallrave dhe shërbimeve, i cili është pak më i fuqishëm se sa pritej për shkak të arritjeve më të mira të eksportit. Kontribut shtesë ka edhe konsumi personal, i cili vazhdon të rritet, me dinamikë pak më të fuqishme se sa pritej. Megjithatë, rënia e mëtejshme dhe e fortë e investimeve bruto, në vend të pritjeve për rritjen e tyre, si dhe rënia e konsumit publik, shkaktuan kontribut negativ nga kërkesa e brendshme në tremujorin e tretë, kundrejt pritjeve për kontribut të vogël pozitiv. Shikuar në mënyrë kumulative, për tre tremujorët e parë të vitit 2023, rritja reale e ekonomisë arrin në 1,2% me bazë vjetore. Përndryshe, EShS-ja gjatë kësaj periudhe ka bërë rishikimet e zakonshme të të dhënave të rritjes, duke filluar nga tr.1 2021 deri në tr.2 të vitit 2023. Kështu, norma reale e rritjes së PBB-së për dy vitet e mëparshme është rishikuar në rritje, në mënyrë më konsideruese për vitin 2021 (prej 3,9% në 4,5% për vitin 2021 dhe nga 2,1% në 2,2% për vitin 2022), dhe rishikim më pak i rënies është bërë për gjysmën e parë të vitit 2023 (prej 1,4% në 1,3%), për shkak të revizionit të vlerësimeve të rritjes në tremujorin e parë (prej 2,1 në 1,5%).

Tregues të përzgjedhur makroekonomik ^{1/}	2022															2023																						
	2016	2017	2018	2019	2020	2021	jan.	shk.	mars	Tr.1	prill	maj	qershor	Tr. 2	korrik	gusht	shtator	Tr.3	tet.	nën.	dhjet.	Tr.4	2022	jan.	shk.	mars	Tr.1	prill	maj	qershor	Tr. 2	korrik	gusht	shtator	Tr.3	tet.	nën.	
I. Sektori real treguesit																																						
Produkti bruto i brendshëm (ritrja reale vjetore) ^{1/2}	2.8	1.1	2.9	3.9	-4.7	4.5								4.0				1.8				1.5	2.2				1.5				1.1				1.2			
Prodhim industrial ^{1/3}																																						
norma e ndryshimit (vjetore)	3.4	0.2	5.4	3.7	-9.5	1.4	0.7	6.2	3.2	3.4	-3.8	8.6	-0.2	1.3	-5.0	0.2	-0.5	-1.8	-5.2	-3.7	-1.3	-3.4	-0.2	-2.3	1.0	1.2	0.1	-1.6	6.1	3.7	2.7	-1.7	-5.1	4.5	-0.7	9.9		
norma mesatare kumulative	3.4	0.2	5.4	3.7	-9.5	1.4	0.7	3.6	3.4	3.5	1.5	2.9	2.3	2.3	1.2	1.1	0.9	0.9	0.3	-0.1	-0.2	-0.2	-0.2	-2.3	-0.5	0.1	0.1	-0.3	1.0	1.5	1.5	1.0	0.3	0.8	0.8	1.7		
Inflacioni ^{1/4}																																						
CPI inflacioni (vjetore) ^{1/5}	-0.2	2.4	0.9	0.4	2.3	4.9	6.7	7.6	8.8	7.7	10.5	11.9	14.5	12.3	16.0	16.8	18.7	17.2	19.8	19.5	18.7	19.3	18.7	17.1	16.7	14.7	16.1	13.0	11.3	9.3	11.2	8.4	8.3	6.6	7.7	3.5	3.1	
CPI inflacioni (mesatare kumulative)	-0.2	1.4	1.5	0.8	1.2	3.2	6.7	7.1	7.7	7.7	8.4	9.1	10.0	10.0	10.9	11.6	12.4	12.4	13.2	13.8	14.2	14.2	14.2	17.1	16.9	16.1	16.1	15.3	14.5	13.6	13.6	12.8	12.2	11.5	11.5	10.7	9.9	
Inflacioni bazë (mesatare kumulative)	1.3	2.3	1.5	0.5	0.9	2.4	2.6	3.3	3.8	3.8	4.3	4.8	5.2	5.2	5.5	5.8	6.2	6.2	6.5	6.8	7.1	7.1	7.1	10.8	10.6	10.2	10.2	10.2	9.9	9.6	9.3	9.0	8.7	8.7	8.4	8.2		
Inflacioni bazë (vjetore) ^{1/5}	1.0	2.8	1.4	-0.3	1.9	2.9	2.6	3.9	4.9	3.8	5.8	6.6	7.3	6.6	7.3	8.1	8.9	8.1	9.2	9.8	10.8	9.9	10.8	10.8	10.4	9.5	10.2	10.1	8.9	8.2	9.1	7.4	7.1	6.3	6.9	6.2	6.2	
Fuqia punëtore																																						
Norma e papunësisë ^{11/}	23.7	22.4	20.7	17.3	16.4	15.7				14.7				14.5				14.3				14.0	14.4				13.3				13.1				12.8			
II. Sektori fiskal treguesit																																						
(Buxheti qendror dhe Buxheti i fondeve)																																						
Gjithësi të hyrjave buxhetore	169,356	179,673	188,505	203,822	189,554	218,021	16,761	18,844	21,501	57,106	21,745	16,890	20,572	59,207	21,225	19,308	21,739	62,272	21,838	18,958	23,704	64,500	243,085	19,268	18,749	27,992	66,009	21,207	22,296	21,639	65,142	22,595	22,006	21,728	66,329	26,875		
Gjithësi shpenzimet buxhetore	185,407	196,561	200,071	217,445	243,421	256,906	20,220	22,241	21,316	63,777	19,753	20,647	22,483	62,883	21,051	20,264	26,694	68,009	22,108	26,456	35,363	83,927	278,596	20,681	23,002	25,849	69,532	30,184	24,814	30,202	85,200	26,057	22,007	22,248	70,312	24,370		
Bilanci buxhetor (para të gjitha pasive)	-16,051	-16,888	-11,566	-13,623	-53,867	-38,885	-3,459	-3,397	185	-6,671	1,992	-3,757	-1,911	-3,676	174	-956	-4,955	-5,737	-270	-7,498	-11,659	-19,427	-35,511	-1,413	-4,253	2,143	-3,523	-9,977	-2,518	-8,563	-20,058	-3,462	-1	-520	-3,983	2,505		
Bilanci buxhetor (% nga PBB-ja) ^{1/}	-2.7	-2.7	-1.8	-2.0	-8.0	-5.3	-0.4	-0.4	0.0	-0.8	0.2	-0.5	-0.2	-0.5	0.0	-0.1	-0.6	-0.7	0.0	-0.9	-1.5	-2.4	-4.4	-0.2	-0.5	0.2	-0.4	-1.0	-0.3	-1.0	-2.3	-0.4	0.0	-0.1	-0.5	0.3		
III. Treguesit financiar^{1/6}																																						
Oferta monetare (M4), norma vjetore e rritjes	6.2	5.1	11.8	9.3	6.9	7.0	6.5	5.3	2.8	2.8	3.0	1.8	1.4	1.4	1.9	1.3	2.9	2.9	3.5	4.6	5.1	5.1	5.1	4.5	5.7	6.9	6.9	8.6	10.5	11.4	11.4	10.6	9.8	8.8	8.8	8.3	8.3	
Totali i kredite, norma vjetore e rritjes	-0.1	5.4	7.3	6.0	4.7	8.3	8.4	8.9	9.8	9.8	10.0	9.9	10.0	10.0	9.7	9.7	9.9	9.9	10.1	9.6	9.4	9.4	9.4	8.5	7.7	6.6	6.6	6.3	6.5	6.5	6.5	5.8	6.4	5.8	5.3	5.3	5.3	
Totali i kredite të popullsisë	7.0	9.2	10.3	10.5	8.0	7.8	7.8	7.8	7.9	7.9	7.8	8.0	7.7	7.7	7.6	7.7	7.6	7.6	7.5	7.5	7.3	7.3	7.3	7.4	7.2	6.8	6.8	6.7	6.5	6.4	6.4	6.4	6.7	6.4	6.4	6.3		
Totali i kredite të ndërmarrjeve	-5.3	2.3	4.5	1.9	1.1	8.7	9.0	10.0	11.9	11.9	12.3	11.9	12.4	12.4	12.1	11.9	12.6	12.6	12.9	12.1	11.5	11.5	11.5	9.7	8.2	6.2	6.2	5.9	6.5	6.5	6.5	5.0	5.8	5.1	5.1	4.1	4.1	
Totali i depozitave (me para të depozituara), norma vjetore e rritjes ^{1/7}	6.1	5.0	12.1	9.0	5.7	7.5	7.2	5.8	3.2	3.2	3.4	2.1	1.5	1.5	2.0	1.4	3.2	3.2	4.1	4.9	4.9	4.9	4.9	4.5	5.9	6.9	6.9	8.7	10.7	11.6	11.6	11.2	10.2	9.0	9.0	8.3		
Gjithësi depozita të popullsisë	2.5	6.1	9.5	7.9	4.6	7.1	6.8	6.0	3.9	3.9	4.6	4.5	5.2	5.2	5.2	4.6	5.3	5.3	5.6	5.3	5.8	5.8	5.8	5.9	6.3	8.4	8.4	8.3	8.7	8.8	8.8	8.4	7.0	6.8	6.8			
Totali i depozitave të ndërmarrjeve	13.4	2.1	9.5	14.6	10.1	11.6	11.5	8.3	3.9	3.9	1.7	-1.6	-4.8	-4.8	-2.9	-3.8	0.4	0.4	1.5	4.3	3.7	3.7	3.7	2.5	5.9	5.9	5.9	5.9	12.0	17.8	19.7	19.7	18.9	19.0	15.7	15.7	14.1	
Normat e interesit ^{1/8}																																						
Norma e interesit të B3 (në fund të muajit/tremujorit/vitit)	3.75	3.25	2.50	2.25	1.50	1.25	1.25	1.25	1.25	1.25	1.50	1.75	2.00	2.00	2.50	2.50	3.00	3.00	3.50	4.25	4.75	4.75	4.75	4.75	5.25	5.50	5.50	5.50	5.50	5.75	6.00	6.00	6.00	6.15	6.30	6.30	6.30	
Normat e interesit aktive																																						
në denarë	7.0	6.6	6.1	5.6	5.2	4.9	4.6	4.6	4.6	4.6	4.6	4.6	4.6	4.6	4.6	4.7	4.7	4.7	4.7	4.7	4.7	4.7	4.6	5.1	5.1	5.2	5.1	5.2	5.2	5.3	5.2	5.6	5.7	5.7	5.7	5.8		
valutore (agregate, për valutë dhe në denarë me klauzolat valutore)	5.7	5.3	4.9	4.6	4.3	4.1	4.0	4.0	4.0	4.0	3.9	3.9	3.9	3.9	4.0	4.0	4.0	4.0	4.1	4.1	4.1	4.1	4.0	4.9	4.9	4.9	4.9	4.9	4.9	4.9	4.9	5.3	5.3	5.2	5.3	5.2		
Norma e interesit pasive																																						
në denarë	2.5	2.2	2.0	1.9	1.5	1.2	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.0	1.1	1.0	1.1	1.2	1.3	1.2	1.1	1.3	1.4	1.5	1.4	1.6	1.6	1.8	1.7	1.9	2.0	2.0	2.0	2.1		
valutore (agregate, për valutë dhe në denarë me klauzolat valutore)	1.0	0.9	0.8	0.8	0.6	0.5	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.4	0.5	0.6	0.5	0.4	0.6	0.7	0.8	0.7	0.9	0.9	1.0	0.9	1.1	1.2	1.2	1.2	1.3		
IV. Sektori i jashtëm treguesit																																						
Bilanci tregtar (në milionë euro)^{1/9}	-252.5	-78.3	22.38	-334.7	-318.0	-329.0	-3.1	-254.3	-134.4	-391.8	-165.7	-68.5	-2.8	-236.9	79.8	61.7	-35.6	105.9	-71.9	-34.0	-168.7	-274.6	-797.4	-14.6	19.9	94.6	99.9	-92.2	25.2	-50.5	-117.5	130.3	29.1	99.5	258.9			
Bilanci i llogarit rrjedhëse (e PBB-së)	-2.6	-0.8	0.21	-3.0	-2.9	-2.8	0.0	-2.0	-1.0	-3.0	-1.3	-0.5	0.0	-1.8	0.6	0.5	-0.3	0.8	-0.6	-0.3	-1.3	-2.1	-6.2	-0.1	0.1	0.7	0.7	-0.7	0.2	-0.4	-0.8	0.9	0.2	0.7	1.8			
Bilanci tregtar (në milionë euro)^{1/9}	-1,786.2	-1,816.2	-1,811.4	-2,007.7	-1,816.6	-2,715.7	-262.7	-312.3	-324.8	-899.8	-404.6	-315.8	-259.6	-980.0	-269.4	-350.8	-342.1	-962.3	-333.9	-283.8	-363.6	-981.3	-3,823.4	-228.1	-196.1	-209.3	-633.5	-195.6	-215.2	-241.9	-652.6	-201.4	-309.6	-210.4	-721.4	-275.8		
Bilanci tregtar (% e PBB-së)	-18.0	-18.1	-16.9	-17.8	-16.7	-23.2	-2.0	-2.4	-2.5	-7.0	-3.1	-2.4	-2.0	-7.6	-2.1	-2.7	-2.7	-7.5	-2.6	-2.2	-2.																	


Kërkesa e huaj efektive (ndryshime vjetore në %)



Vlerësime thuajse të pandryshuara për rritjen e **kërkesës së huaj** për të gjithë periudhën e parashikimeve.

Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.


Kërkesa e huaj efektive (ndryshime vjetore në %)



Korrigjime minimale rritëse në **inflacionin efektiv të huaj** për vitin 2023 dhe 2024, me pritshmëri për norma pak më të larta të inflacionit tek disa prej partnerëve tanë të importit.

Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Kursi i këmbimit euro/Dollari amerikan




Pritjet për zhvlerësim të mëtejshëm **të dollarit amerikan në kundërvlerë të euros**, por mesatarisht me më pak intensitet se sa ishte parashikuar në tetor, për të gjithë periudhën e parashikimit.

Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Nafta "brent"


(mesatarja tremujore, euro/fuqi)



Burimi: FMN-ja , Banka Botërore dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Çmimet e nikelit dhe bakrit në euro

(ndryshime vjetore në %)




Burimi: FMN-ja , Banka Botërore dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Rishikime divergjente tek çmimet e produkteve primare⁴ në periudhën e parashikimit, por ende pritjet rënie e çmimeve në vitin aktual dhe vitin e ardhshëm...

... në pjesën më të madhe për shkak të pritjeve për kërkesë më të dobët, gjatë perspektivave të përkeqësimit të ekonomisë botërore.

Çmimet e grurit dhe misrit në euro


(ndryshime vjetore në %)



Burimi: FMN-ja , Banka Botërore dhe llogaritjet e BPRMV-së.

⁴ Për analizën e çmimeve të naftës, metaleve dhe produkteve primare ushqimore përdoren raporte të ndryshme të FMN-së, Bankës Botërore, FAO, OPEC, BQE dhe në portalet e specializuara ekonomike ndërkombëtare.

Euribor-i njëmuor (mesatarja tremujore, në %)



Revizione pak rritëse në Euribor njëmuor për vitin 2023 dhe 2024, dhe rënëse për vitin 2025, me ruajtjen trajektore rënëse të borxhit, në linjë me pritjet e tregut për ulje të normave të interesit të BQE-së në gjysmën e dytë të vitit të ardhshëm.

Burimi: "Consensus Forecast" dhe vlerësimet e BPRMV-së.

Indeksi Financiar i stresit




Treguesi i stresit financiar global⁵ ende tregon për ndryshueshmëri pak të ulët në tregjet financiare.

⁵ Indeksi KFI IFS (agn. OFR FSI) mat stresin sistematik financiar – çrregullime në funksionimin normal të tregjeve financiare. Ai përbëhet nga 33 variabla të tregut financiar, të agreguar në pesë kategori treguesish: krediti, vlerësimi i kapitalit, financimi, mjetet e sigurta/pa rrezik dhe paqëndrueshmëria. Vlera e indeksit në ditë të caktuar përfaqëson nivel mesatar të ponderuar të çdo variabli të vëzhguar të tregut atë ditë, në raport me vlerën e tij historike, me ç'rast indeksi është pozitiv kur niveli i stresit është mbi mesataren dhe negativ kur niveli i stresit është nën mesataren.

Norma e inflacionit

(kontributet vjetore në inflacionin e përgjithshëm, në pp)



Burimi: Instituti Shtetëror i Statistikave dhe Llogaritjeve i NBRSM.


Në nëntor 2023, çmimet e konsumit të brendshëm kanë mbetur në nivel relativisht stabil (rritje e parëndësishme prej 0,1% me bazë mujore).

Çmimet e produkteve ushqimore u ulën për 0,3%, me çmime më të ulëta në pjesën më të madhe të kategorive të produkteve, kryesisht tek frutat.

Çmimet e energjisë shënuan rënie mujore prej 0,5%, si rezultat i rënies së çmimeve të derivateve të naftës, në pajtim me lëvizjet e bursës botërore.

Inflacioni dhe çmimet e ushqimeve dhe energjisë


(ndryshimet vjetore, në %)



Burimi: Instituti Shtetëror i Statistikave dhe Llogaritjeve i NBRSM.

Inflacioni bazë në bazë mujore arrin 0,6%, kryesisht si pasojë e rritjes së çmimeve të duhanit dhe pajisjeve dhe shërbimeve të komunikimit.

Kontributet në normën vjetore të inflacionit (në pp)




Burimi: ZSHS dhe NBRSM.

Norma vjetore e inflacionit në nëntor ka vazhduar të ngadalësohet dhe u reduktua në 3,1%, me shterim pothuajse të plotë të presionit nga komponenti ushqimor⁶ dhe energjitik dhe ulje të mëtejshme të kontributit të komponentit bazë.

⁶ Qeveria e RMV-së, gjatë shtatorit, miratoi vendime të cilat i referohen uljes dhe ngrirjes së çmimeve të produkteve në kuadër të 24 kategorive nga furrat e bukës, qumështit, industria e mishit, dhe bujqësia (lidhja), çmimi i disa pijeve, reduktimin e marzheve tregtare në fruta dhe perime (lidhja), uljen dhe heqjen e detyrimeve të importit në produktet e caktuara (lidhja), me vlefshmëri deri në fund të vitit në lidhje me masën e ngrirjes së çmimeve. Nga ana tjetër, me vendimin për rritjen e normës preferenciale të TVSH-së prej 5% në 10% në disa produkte ushqimore, të miratuara në muajin tetor, është ndikohet për rritje të caktuar të atyre mallrave (lidhja).


Përhapja midis inflacionit të brendshëm dhe inflacionit në Eurozonë (në pp)



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikave dhe Eurostat.

Diferenca në raport me inflacionin në Eurozonë⁷ u ngushtua ndjeshëm në tetor, me ngadalësim më të theksuar të inflacionit të brendshëm.


Pritjet e konsumatorëve për ndryshimet e çmimeve gjatë 12 muajve të ardhshëm (përgjigjja e bilanceve)



Burimi: Komisioni Evropian.

Pritjet e konsumatorëve⁸ të dhënë në anketat e muajit nëntor për lëvizjen e çmimeve në periudhën e ardhshme janë më të favorshme krahasuar me muajin tetor.

Pritjet inflacioniste të drejtuesve të kompanive për 3 muajt e ardhshëm (përgjigjja e bilanceve)



Burimi: Komisioni Evropian.

Lidhur me **sektorin korporativ⁹**, pritjet për lëvizjen e çmimeve në periudhën e ardhshme janë më të favorshme në sektorin e shërbimeve dhe ndërtimtarit dhe më pak të favorshme në industrinë përpunuese dhe tregtinë me pakicë.

Norma vjetore e inflacionit të realizuar në nëntor është më e ulët se norma e parashikuar nga cikli i parashikimeve të

⁷ Në bazë të Indeksit të Harmonizuar të Çmimeve të Konsumit, për të cilin të dhënat e fundit të publikuara për vendin janë për muajin tetor.


⁸ Anketa e komisionit evropian për optimizmin konsumator prej nëntorit 2023, në bazë të çështjes për "pritjet e konsumatorëve për ndryshimet e çmimeve gjatë 12 muajve të ardhshëm".

⁹ Anketa për tendencat afariste të Komisionit Evropian në industrinë, tregtinë me pakicë, ndërtimtarinë dhe në sektorin e shërbimeve.

tetorit, si rezultat i devijimeve në komponentin ushqimor dhe energjetik.

Lëvizjet e pritshme të supozimeve të hyrjeve të jashtme në parashikimin e inflacionit janë pothuajse të pandryshuara. Në të njëjtën kohë, pasiguria e dinamikës së ardhshme të çmimeve të produkteve primare në bursë është ende e pranishme dhe e lartë.


Çmimet e huaja efektive* dhe vendase të ushqimeve dhe pijeve joalkoolike (indekset, 2015=100)



* Çmimet efektive të ushqimeve të huaja fitohen si shumë e ponderuar e çmimeve të ushqimeve në vendet që janë partnerët më të rëndësishëm tregtarë të Maqedonisë së Veriut në fushën e importit të ushqimeve.

Burimi: Logaritjet e ZSHS, Eurostat dhe NBRSM.

Paga mesatare e paguar
(normat vjetore, në %)



Burimi: EShS.

Në shtator 2023, **paga mesatare nominale neto** shënoi përshejtim të rritjes mujore dhe vjetore kryesisht si pasojë e rritjes së pagave të punonjësve në sektorin publik.¹⁰ ...


... rrjedhimisht, përshejton rritja vjetore e pagave në veprimtaritë e shërbimeve, me rritje të fuqishme edhe në industri, ndërsa në bujqësi dhe ndërtimtari rritja e pagave ngadalësohet...

... dhe gjithashtu përshejtohet rritja e **pagës reale neto**, në pajtim me ngadalësimin e inflacionit dhe përshejtimin e rritjes nominale të pagave.

Ndryshimi nominal dhe real vjetor i realizuar i pagave në tremujorin e tretë të vitit 2023 është minimalisht më i lartë krahasuar me parashikimin e tetorit.

¹⁰ Në korrik të vitit 2023, Qeveria nënshkroi marrëveshje të re kolektive për sektorin publik, që përfshin rritje të pagave prej 10% nga shtatori 2023, rritje shtesë të pagave në shtator 2024 nëse norma vjetore e inflacionit në gjashtë muajt e parë të vitit 2024 tejkalon 3% (paga bazë bruto rritet në shumë përqindje për diferencën deri në 3%) dhe revizion të metodologjisë për përcaktimin e pagave nga marsi 2025 që e lidh pagën bazë bruto me pagën mesatare bruto në nivel të shtetit me rritje të koeficientit të kompleksitetit prej së paku 5%. Për më tepër, koeficienti i kompleksitetit të vendit të punës do të harmonizohet me rritjen nominale të PBB-së nëse i njëjti është më i ulët se rritja mesatare e pagës bruto.

Paga mesatare mujore neto e paguar sipas sektorëve
(normat nominale vjetore, në %)



Burimi: EShS-ja.

Tregu i punës¹¹ në tremujorin e tretë të vitit 2023 shënoi lëvizje pozitive në bazë tremujore...

...**norma e punësimit** u rrit për 0,2 p.p. dhe është 45,7%, në kushte të rritjes prej 0,4% të numrit të të punësuarve në krahasim me tremujorin e kaluar...

...**norma e papunësisë** shënoi ulje të mëtejshme dhe u reduktua në 12,8%, me rënien të numrit të personave të papunësuar prej 1,7%.

Nga aspekti i ofertës së fuqisë punëtore, në tremujorin e tretë u shënuar rritje e lehtë e popullsisë aktive (për 0,2%), ndërsa popullsia joaktive mbeti e pandryshuar.


Në tremujorin e tretë të vitit 2023 rritja reale e PBB-së shënon 1,2% në bazë vjetore (rritje prej 1,1% në tremujorin e kaluar)...

... që është në linjë me rritjen e parashikuar për këtë tremujor nga cikli i parashikimeve të tetorit.

Shikuar nga ana e shpenzimeve të PBB-së, rritja në tremujorin e tretë i detyrohet kontributit pozitiv të eksportit neto në kushtet e rënies më të vogël të eksportit krahasuar me rënien e

¹¹ Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore (AFP) për tre tremujorët e parë të vitit 2023 nuk janë të krahasueshme me të dhënat e tremujorëve të mëparshëm të viteve të tjera, sepse në vitin 2023 është implementuar Rregullorja e re (BE) nr. 2019/1700 të Parlamentit Evropian dhe Këshillit për Statistikat Sociale dhe rregullorja ekzekutive përkatëse e Komisionit (BE) nr. 2019/2240 për fushën e fuqisë punëtore, me ç'rast Rregullorja e mëparshme (KE) nr. 577/98 është shfuqizuar. Zbatimi i rregullores së re shkaktoi ndryshime në hulumtimin, duke filluar me ndryshimet në dizajnin e pyetësorit, ndryshimi i renditjes së pyetjeve, ndryshimet dhe heqja e pyetjeve ekzistuese dhe shtimi i pyetjeve të reja, ndryshimet në shtrirjen dhe përkufizimin e punësimit dhe papunësisë. Me këtë rast, në këtë muaj bëjmë analizë vetëm mbi bazën e të dhënave të krahasueshme të vitit 2023, gjegjësisht analizë të ndryshimeve tremujore.

Prodhimi i brendshëm bruto
(normat reale vjetore, në %)



Burimi: ESHS-ja dhe llogaritjet e BPRMV-së.


Ndryshimet në seri në periudhën e arritur janë për shkak të rishikimeve të rregullta të ESHS-së.

importit të mallrave dhe shërbimeve. Kërkesa e brendshme shënoi rënie, me rënie reale të lartë të investimeve bruto dhe ulje të konsumit publik, me rritje të mëtejshme solide të konsumit personal.

Shikuar nga ana e prodhimit të PBB-së, rritja në tremujorin e tretë në masë të madhe i detyrohet kontributit pozitiv të "veprimtarive në lidhje me pasurinë e paluajtshme", "informacionet dhe komunikimet" dhe grupi veprimtari "tregti, transport dhe hotelieri".

Në bazë tremujore, PBB-ja në tremujorin e tretë shënoi rritje reale minimale prej 0,2%¹².

Treguesi i besueshmërisë ekonomike dhe PBB-ja



Burimi: ESHS-ja dhe Komisioni European


Në kushte të vëllimit të kufizuar të të dhënave në dispozicion, është e vështirë të jepet vlerësim i saktë i gjendjes së plotë në ekonominë reale në tremujorin e katërt të vitit 2023.

Rezultatet e hulumtimeve të anketave për periudhën tetor-nëntor 2023 tregojnë perceptime më të favorshme në raport me tremujorin e katërt të vitit 2022, ndërsa në raport me tremujorin e kaluar janë disi më pak të favorshme¹³.

¹² Sipas të dhënave të përshtatura sezonale dhe kalendrike të ESHS-së.

¹³ I referohet anketave të zbatuara nga Komisioni European për matjen e besimit ekonomik të subjekteve në një ekonomi. Treguesi i përbërë i besimit ekonomik fitohet si mesatare e ponderuar e treguesve të besimit për konsumatorët dhe treguesit e besimit për sektorët e veçantë ekonomikë (ndërtimtari, industri, tregti me pakicë dhe shërbime).

**Sektorët ekonomikë
(ndryshimet reale vjetore, në %)**



* Mesatarja e thjeshtë e normave vjetore të ndryshimit të mënyrave të ndryshme të transportit dhe telekomunikacionit.
Burimi: ESHS-ja dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Në muajin tetor, **qarkullimi në totalin e tregtisë** shënoi rënie reale në bazë vjetore, por më e vogël krahasuar me rënien në tremujorin e kaluar...

... në kushtet e rënies në të tre llojet e tregtisë (tregtia me pakicë, tregtia me shumicë dhe tregtia me automjetet).

Në muajin tetor **prodhimi industrial** shënoi rritje reale solide në bazë vjetore, kundrejt rënies së vogël në tremujorin e kaluar...

... kryesisht si rezultat i rritjes së industrisë përpunuese (në radhë të parë prodhimi i produkteve ushqimore, automjeteve motorike, si dhe riparimi dhe instalimi i makinerive dhe pajisjeve), dhe kontribut pozitiv vërehet edhe në minierat dhe në energjinë.

Treguesit e disponueshëm të **kërkesës agregate** janë gjithashtu në vëllim relativisht të kufizuar, që e bën të pamundur formimin e vlerësimit më të saktë të lëvizjes së përbërësve individualë të kërkesës në tremujorin e katërt të vitit 2023..

Të dhënat e disponueshme për lëvizjet e **konsumit personal** për muajin tetor 2023 janë aktualisht më të favorshme në krahasim me tremujorin e kaluar (rënie më e moderuar e të ardhurave bruto nga TVSH-ja dhe tregtia me pakicë, me rritje të prodhimit vendas të mallrave të konsumit dhe rritje të përforcuar të importit të mallrave për konsum të gjerë dhe pensionet).

Në kontekst të të dhënave me frekuencë të lartë të tetorit për **investimet bruto**, lëvizjet janë të favorshme...

... gjatë rritjes së prodhimit të përgjithshëm industrial, importi i mjeteve për punë, tatimi mbi fitimin, prodhimi vendas i mallrave kapitale, prodhimi i produkteve të tjera minerale jometalike, investimet kapitale shtetërore, si dhe mbështetja e mëtejshme kreditore e ndërmarrjeve.


Të dhënat për **shkëmbimin e tregtisë së jashtme** në tetor 2023 tregojnë për ngushtim të mundshëm të deficitit në krahasim me të njëjtën

PRODHIMI INDUSTRIAL DHE VEPRIMTARI TË TJERA EKONOMIKE																
	2020				2021				2022				2023			
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	okt.
	ndryshime reale vjetore në %															
Produkti bruto i brendshëm	-0,3	-15,4	-4,3	1,3	0,1	14,5	1,4	1,2	1,7	4,0	1,8	1,5	1,5	1,1	1,2	-
Prodhim industrial	-3,7	-25,0	-7,5	-2,3	-6,1	22,3	-3,5	-2,3	3,4	1,3	-1,8	-3,4	0,1	2,7	-0,6	9,9
Punimet e realizuara ndërtimore	6,3	-5,1	3,0	2,3	-1,1	-9,6	-10,8	-17,5	-11,1	-1,2	-19,2	-14,0	14,7	-21,2	-8,4	-
Ndërtim i lartë	-8,5	-20,4	17,9	-8,6	18,5	5,3	-20,2	-20,9	-26,0	15,2	-8,8	6,7	15,6	-19,7	-9,8	-
Ndërtim i ulët	21,3	4,7	-6,2	11,1	-16,1	-16,9	-3,5	-15,2	5,1	-11,3	-25,9	-26,9	13,9	-22,3	-7,2	-
Qarkullim në tregtinë me shumicë - Gj	-16,7	-30,6	-26,1	-24,3	0,9	22,5	16,9	10,4	9,7	4,0	0,4	-2,7	3,7	-5,2	-6,3	#REF!
Qarkullim në tregtinë me pakicë*	1,0	-18,6	-15,7	-15,5	-1,3	18,3	13,9	10,0	7,6	6,7	1,9	-3,7	1,4	-8,1	-9,8	#REF!
Qarkullim në tregtinë me shumicë*	-27,8	-40,1	-38,7	-36,5	3,7	27,8	24,8	19,6	11,0	2,4	-1,3	-3,0	3,8	-3,9	-4,4	#REF!


*Bazëjt reale të rritjes logaritme nga BIPV2015, gjatë periudhës normale të rritjes me inflacionin vjetor, të matur sipas ashpërsimit të përbërës. Të dhënat e tregutit në 2021, 2022 dhe 2023 janë të dhëna të forajshme, ndërsa të dhënat e BIPV-së për 2021 dhe 2022 janë të ardhmave ndërsa për PIB-in në 2023 janë të ardhmave.

*Rritjet reale të rregjës llogarit nga BPRMV-ja, duke përdorur normat nominale të rregjës me inflacionin vjetor, të matur sipas shprehjeve të jetesës. Të dhënat e tregtisë në 2020, 2021, 2022 dhe 2023 janë të dhëna të ardhshme, ndërsa të dhënat e PBB-së në 2021 dhe 2022 janë të ardhshme ndërsa për PBB-në në 2023 janë vlerësuar.
Burimi: ESHS-ja dhe llogaritjet e BPRMV-së.

**Treguesit e lëvizjes së konsumit personal
(normat reale vjetore, në %)**




Burimi: ESHS-ja dhe llogaritjet e BPRMV-së.

Treguesit e lëvizjes së investimeve bruto
(normat reale vjetore, në %)

Burimi: ESHS-ja dhe llogaritjet e BPRMV-së.


periudhë të vitit të kaluar, me rënie nominale më të lartë të importit krahasuar me rënien e eksportit të mallrave.

Arritjet buxhetore në pajtim me të dhënat fiskale për muajin tetor 2023 tregojnë rritje reale vjetore të **konsumit publik**.




Deficiti në shkëmbimin e mallrave me vendet e huaja në tetor 2023 u reduktua për 17,4% në bazë vjetore, lëvizur nga importi njëkohësisht më i ulët dhe eksporti i mallrave, me rënie më të theksuar të komponentit të importit.

Eksporti i mallrave në tetor të vitit 2023 shënoi rënie prej 8,9% në bazë vjetore, kryesisht duke lëvizur nga eksporti më i ulët i energjisë elektrike, si dhe nga eksporti më i ulët i një pjese të kapaciteteve prodhuese në pronësi të huaj nga industria e automobilave. Arritjet në eksportin janë aktualisht në linjë me parashikimin e tetorit.






Importi i mallrave në tetor 2023 shënoi rënie prej 11,5% në bazë vjetore, e cila më së shumti vjen si pasojë e uljes së importit të energjisë, si dhe uljes së importit të një pjese të kapaciteteve prodhuese në pronësi të huaj të industrisë së automobilave, përkthësisht të performancave të eksportit. Krahasuar me parashikimin e tetorit, arritjet e importit për momentin janë disi më të ulëta.

Deficiti tregtar në tetor 2023 për momentin tregon mundësinë e arritjes së deficitit disi më të ulët se sa pritej për tremujorin e katërt të vitit, sipas parashikimit të tetorit.




Në tetor të vitit 2023, treguesit e REDK-së shënuan apreciacion në bazë vjetore, tërësisht nën ndikimin e apreciacionit të NEDK-së (kryesisht për shkak të zhvlerësimit të lirës turke në kundërvlerë me denarin), me rënie të kostove relative të jetesës dhe çmimet relative të produkteve industriale.

Në indekset e REDK-së, sipas përlogaritjes me ponderë të bazuar mbi shkëmbimin e tregtisë së jashtme pa produkte primare lëvizjet janë të ngjashme, ku REDK-ja e deflatuar me kostot e jetesës shënoi zhvlerësim të lehtë.



Në tremujorin e tretë të vitit, llogaria rrjedhëse shënoi suficit prej 258,9 milionë euro, ose 1,8% të PBB-së, që është në linjë me pritjet e parashikimit të tetorit...


... me deficit tregtar të arritur më të ulët se sa pritej (eksport më të lartë të mallrave se sa pritej) dhe suficit më të ulët në shërbimet (shërbime tjera më të ulëta dhe shërbime të përfundimit).

Komponentët e llogarisë financiare
(në milionë euro)

Burimi: BPRMV.


Në llogarinë financiare janë realizuar dalje neto prej 589,4 milionë euro (ose 4,2% e PBB-së), të cilat janë në linjë me pritjet në pajtim me parashikimet e tetorit.

Lëvizjet e tregut të këmbimit



*Të dhënat e fundit të disponueshme: 30.11.2023


Blerja neto e tregut të këmbimit e realizuar në periudhën tetor - nëntor 2023 është pak më e lartë nga ajo që është arritur periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, e cila aktualisht i referohet arritjeve më të mira në transferimet private sesa pritej për tremujorin e katërt në pajtim me parashikimin e tetorit.

Rezerva valutore bruto
(gjendja në milionë euro)

*Të dhënat e fundit të disponueshme: 30.11.2023


Rezervat valutore bruto në fund të nëntorit të vitit 2023 shënojnë 3.963,7 milionë euro dhe shënojnë rritje në krahasim me fundin e tremujorit të tretë të vitit, që kryesisht vjen si pasojë e blerjes së valutës së huaj të Bankës Popullore në tregun e këmbimit valutor.

Faktorë të ndryshimit të rezervave valutë tetor dhe nëntor të vitit 2023
(në milionë euro)




Burimi: BPRMV-ja

Tregu valutor
(miliona euro)



Në periudhën tetor - nëntor, në tregun e këmbimit valutor të bankave është regjistruar blerje neto e valutave, kundrejt shitjes neto të realizuar në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, në kushte të rritjes së ofertës dhe rënie të njëkohshme e kërkesës së valutave të huaja.


Struktura e tregut valutor
(shitja/blerja neto, në milionë euro)



Analiza sektoriale tregon se zhvendosjet e tilla të tregut të këmbimit valutor në pjesën më të madhe dalin nga shitja më e ulët neto e kompanive.

Instrumente monetare

(gjendjet në fund të muajit, në milionë denarë)




Gjendja e instrumenteve monetare në fund të tetorit 2023 u rrit në krahasim me muajin e kaluar, për shkak të rritjes së shumës së mjeteve të bankave të vendosura në depozitat e disponueshme në Bankën Popullore.

Niveli i instrumenteve monetare në fund të tetorit është më i lartë krahasuar me nivelin e parashikuar për fundin e tremujorit të katërt të vitit 2023, me rënie neto të aktiveve në valutë të huaj të Bankës Popullore dhe devijim më të madh të rënies në depozitat totale të shtetit. Gjithashtu, realizimet tek paratë primare janë nën vlerat e parashikuara sipas parashikimit të tetorit.




Burimi: BPRMV-ja

Depozita në total



(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)



- Depozita të sektoreve tjera*
- Depozita në valutë të huaj
- Depozita të ndërmarrjeve
- Depozita, / ndryshim mujore/vjetor, në %
- Depozita në valutë të brendshme
- Para të depozituara
- Depozita të amvisërive
- Depozita, / ndryshime vjetor, në %

*Në depozita të sektoreve tjera janë të përfshira depozita të institucioneve financiare tjera, depozitat e vetëqeverisjes lokale dhe depozitave të institucioneve jofitimprurëse që u shërbejnë amvisërive të bankat, si dhe depozitat e transferueshme në denarë të institucioneve tjera financiare dhe të vetëqeverisjes lokale të Banka Popullore


Depozitat totale¹⁴ në sistemin financiar në bazë mujore u ulën në tetor të vitit 2023, gjatë uljes së depozitave të kompanive, gjegjësisht të depozitave në valutë të huaj dhe të brendshme.

Depozitat totale në tetor 2023 janë më të ulëta se tremujori i tretë, me rritje të pritshme në tremujorin e katërt, sipas parashikimit të tetorit.

Norma e rritjes vjetore të depozitave totale në tetor 2023 ishte 8,3%, afër normës së parashikuar për tremujorin e katërt të vitit 2023 prej 8,4%.


¹⁴ Të dhënat i referohen depozitave të sektorit jo-shtetëror në bankat dhe shtëpitë kursimore, mjetet e institucioneve të tjera financiare në llogaritë e BPRMV-së dhe mjetet e njësive të vetëqeverisjes lokale të llogaritë të BPRMV-së. Të dhënat korrespondojnë me ndryshimet metodologjike të BPRMV-së nga qershori i vitit 2018. Më shumë informata mbi ndryshimet metodologjike mund të gjeni në lidhjen si vijon: http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nsp.x.

Depozita të amvisërive
(kontribute në p.p., ndryshim mujore)



Rritja e vogël mujore e **depozitave të shtëpive** është realizuar në tetor të vitit 2023, me rritjen e depozitave afatgjata, si dhe të depozitave në valutë vendase dhe të huaj. Në bazë vjetore, depozitat e shtëpive në tetor 2023 janë rritur për 6,8%.

(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)




Burimi: BPRMV-ja


Lëvizjet në strukturën e valutës së depozitave totale të shtëpive prej dhjetor 2022 e këndej janë më të favorshme dhe janë reflektim i forcimit të denarizimit.

Depozita në denarë dhe valutë të amvisërive/totali i depozitave të amvisërive

(pjesëmarrje në fund të muajit, në përqindje)



(pjesëmarrje në fund të vitit, në përqindje)




*Totali i depozitave vetëm në banka dhe kursimoret.


Burimi: BPRMV-

Oferta monetare M4

(kontribute në p.p., ndryshime mujore)



(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)



■ GPO jashtë nga institucionet depozitare
■ Totali i depozitave afatshkurtra
■ Totali i depozitave në valutë
● M4, ndryshime vjetore, në %


Burimi: BPRMV-ja

Masa e parasë e shprehur përmes agregatit monetar më të gjerë M4, në tetor 2023, shënoi rënie mujore prej 0,4%, si rezultat i uljes tek paratë e depozituara dhe paratë e gatshme në qarkullim. Nga aspekti afatizues vërehet ulje e depozitave afatshkurtra, ndërsa nga ana valutore ka rënie të depozitave në valutë.


Rritja vjetore e masës së parasë në tetor 2023 vazhdoi të ngadalësohet dhe u reduktua në 8,3%, me rritjen e pritshme vjetore prej 8,0% për tremujorin e katërt të vitit 2023, sipas parashikimit të tetorit.

Pjesëmarrje e M4 pjesë në denarë në totalin e ofertës monetare M4

të dhënat në fund të muajit, në %




të dhënat në fund të vitit, në%



Burimi: BPRMV-ja

Pjesëmarrja e denarit pjesë në masën totale të parasë M4 në fund të tetorit mbeti e pandryshuar në krahasim me muajin e kaluar dhe është nën vlerën e parashikuar....

Kredite në total
(kontribute në p.p., ndryshime mujore)




Kreditë totale në muajin tetor shënuan rritje të vogël mujore prej 0,3%.

Në tetor 2023, kreditë totale në raport me tremujorin e tretë shënuan rritje, që për momentin është më e ulët se rritja e pritur për tremujorin e katërt të vitit 2023 sipas parashikimit të tetorit.


Norma vjetore e rritjes së kredive totale në tetor shënoi 5,3% dhe aktualisht është në kuadër të rritjes vjetore prej 5,7% të parashikuar për tremujorin e katërt të vitit 2023, sipas parashikimit të tetorit.

(kontribute në p.p., ndryshime vjetore)




Burimi: BPRMV-ja

**Newly granted loans to private sector,
12-month moving average**




Shuma e kredive totale të reja të miratuara për sektorin privat në 12 muajt e fundit, përfundimisht me muajin e tetorit, mesatarisht është më e ulët në bazë vjetore, lëvizur nga kreditimi i sektorit korporativ me nevoja të reduktuara për likuiditet këtë vit, ndërsa tek shtëpitë ka rritje të vogël vjetore.


**Kredi të reja të amvisërive, 12M
mesatarja lëvizëse, norma vjetore të
rritjes**




**Kredi të reja të ndërmarrjeve, 12M
mesatarja lëvizëse, normat vjetore të
rritjes**



**Raporti ndërmjet kredive totale dhe depozitave
(të dhënat mujore, në përqindje)**




(I ë të dhënat vjetore, në përqindje)




Burimi: BPRMV-ja

Shfrytëzimi i potencialit të depozitave për kreditimin e sektorit privat është rritur lehtë në tetor dhe është mbi parashikimin për fundin e tremujorit të katërt të vitit 2023, sipas parashikimit të tetorit.

Norma e interesit të totalit të depozitave




(Të dhënat në fund të vitit, në përqindje)




Burimi: BPRMV-ja

Në tetor të vitit 2023 normat e interesit të depozitave totale (denarë dhe në valutë)¹⁵ lëvizën lehtë në rritje, ndërsa diferenca e interesit ende mbeti stabil. Në rritje lëvizën edhe normat e interesit në **totalin e depozitave të sapopranuara**¹⁶, më i theksuar te depozitat në denarë, që kontribuoi në diferencë më të lartë të interesit...

Norma e interesit të totalit depozita të amvisërive
(të dhënat mujore, në përqindje)

(Të dhënat në fund të vitit, në përqindje)




Burimi: BPRMV-ja

... lëvizje identike në muajin tetor vërehen edhe në normat përkatëse të interesit në sektorin "shtëpitë", me ngushtim të lehtë të diferencës së depozitave të sapo pranuar.

¹⁵ Të dhënat për normat e interesit janë në pajtim me ndryshimet metodologjike të BPRMV-së nga qershori i vitit 2018. Më tepër informacione rreth ndryshimeve metodologjike mund t'i gjeni në linkun e mëposhtëm: http://www.nbrm.mk/monetarna_statistika_i_statistika_na_kamatni_stapki.nsp.


¹⁶ Lidhur me normat e interesit të depozitave të sapo pranuar duhet pasur parasysh se për ato janë karakteristike lëvizjet e ndryshueshme. Ndryshueshmëria e normave të interesit për depozitat e sapo pranuar rezulton nga fakti se ato kushtëzohen nga vëllimi i depozitave të sapo pranuar (që nga muaji në muaj mund të ndryshojnë) dhe norma e tyre e interesit.

Norma e interesit të totalit të kredite, sipas sektorëve
(ndryshime mujor, në përqindje)



Në tetor të vitit 2023, normat e interesit e **kredive totale të shtëpive dhe kredite totale të ndërmarrjeve ishin të pandryshuara**. Rritje të vogël shënojnë normat e interesit të **kredive të sapomiratuara**¹⁷ të ndërmarrjeve, ndërsa tek shtëpitë ndryshimi është në rënie.


(Të dhënat në fund të vitit, në përqindje)



— Norma Interesi të kredive të amvisërive
— Norma Interesi të kredive të ndërmarrjeve

Burimi: BPRMV-ja


Normat e interesit bazë të BPRMV-së dhe BQE-së (në%) dhe diferenca e tyre (në p.p.)




Diferenca në normat bazë të interesit të Bankës Popullore dhe Bankës Qendrore Europiane është stabil dhe i pandryshuar.

¹⁷ Lidhur me normat e interesit të kredive të sapo miratuara, duhet pasur parasysh se për ato karakteristike janë lëvizjet e ndryshueshme. Ndryshueshmëria e normave të interesit të kredive të sapo miratuara rezulton nga fakti se ato kushtëzohen nga vëllimi i kredive të sapo miratuara (që nga muaji në muaj mund të ndryshojnë) dhe norma e tyre e interesit.

Të hyrat dhe Shpenzime buxhetore (kontribute në ndryshimin vjetor, në p.p.)




Në tetor të vitit 2023, të ardhurat në buxhetin e Republikës së Maqedonisë së Veriut (buxheti qendror dhe buxhetet e fondeve) realizuan rritje të fuqishme, me të ardhura të larta tatimore për shkak të arkëtimit të tatimit të solidaritetit në vlerë prej rreth 2,2 miliardë denarë, ndërsa rritja e shpenzimeve buxhetore është më e moderuar.



Në periudhën janar - tetor 2023, të ardhurat totale buxhetore janë më të larta për 11,9% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, ndërsa shpenzimet totale buxhetore janë më të larta për 15,1%...



Realizimi i Buxhetit, sipas kategorive (Buxheti qendror dhe fondet), në përqindje nga plani vjetor



... dhe deficitin buxhetor i realizuar në vlerë prej 25.059 milionë denarë paraqet 58,6% të deficitit të planifikuar për vitin 2023 në pajtim me buxhetin¹⁸...


Burimi: Ministria e Financave dhe llogaritjet e BPRMV-së.

¹⁸ "Gazeta Zyrtare e RMV-së" nr. 282 prej 7.12.2022.



¹⁹ Në muajin korrik u emetua obligacioni i parë civil në vlerë prej 1.448 milionë denarë me normë interesi prej 5% dhe afat maturimi prej dy vitesh, dhe obligacioni i dytë civil në muajin nëntor në vlerë prej 1.085 milionë denarë me normë interesi prej 5% dhe afat maturimi prej dy vitesh. Gjithashtu, në tetor u emetua edhe obligacioni i parë i gjelbër në vlerë prej 600 milionë denarë me normë interesi prej 4,75% dhe me afat maturimi prej dy vitesh.

²⁰ Në muajin mars u emetua eurobondi i nëntë në vlerë prej 500 milionë euro, me kupon interesi 6,96% dhe me afat maturimi prej katër vitesh. Në korrik është paguar plotësisht eurobondi i emetuar në korrik të vitit 2016, në vlerën prej 450 milionë euro, për 7 vite dhe me normë interesi prej 5,625%.



Burimi: Llogaritjet e BPRMV-së në bazë të të dhënave nga Ministria e Financave.

Reduktimi i **borxhit publik**²¹ në fund të tremujorit të tretë të vitit 2023, nën ndikimin e reduktimit të borxhit të jashtëm publik²².

²¹ Borxhi publik përkufizohet me Ligjin për Borxhin Publik ("Gazeta Zyrtare e RM-së" numër 62/2005, 88/2008, 35/2011, 139/2014 dhe 98/2019) sipas të cilit përfaqëson shumën e borxhi shtetëror dhe borxhi i ndërmarrjeve publike të themeluara nga shteti ose nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit, si dhe shoqëritë tregtare që janë në pronësi të plotë ose dominuese të shtetit ose komunave, komunave në qytetin e Shkupit dhe në Qyteti i Shkupit.

²² Ulja rezultoi nga eurobondi i paguar plotësisht në korrik të vitit 2023, e cila u emetua në korrik të vitit 2016, në vlerën prej 450 milionë euro, për 7 vjet dhe me normë interesi 5,625%.

Shtojca 1: Kategoritë indikative për konsumin personal dhe investimet bruto

KATEGORI INDIKATIVE E KONSUMIT PERSONAL

	2020				2021				2022				2023			
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	tet.
	ndryshime reale vjetore në %															
Qarkullim në tregtinë me pakicë*	1,0	-18,6	-15,7	-15,5	-1,3	18,3	13,9	10,0	7,6	6,7	1,9	-3,7	1,4	-8,1	-9,8	#REF!
Të hyra bruto nga TVSh-ja*	1,8	-20,0	-10,8	-4,2	2,9	36,6	21,1	20,6	29,2	9,5	3,7	-7,7	-15,0	-9,5	-10,7	-5,5
Import i mallrave për konsum të gjerë*	6,9	-12,4	-3,6	-9,4	3,2	26,2	11,4	13,9	-2,9	-1,5	-2,2	-10,1	2,0	4,8	1,4	#REF!
Prodhim i brendshëm i mallrave të konsumit	-0,5	-22,4	-9,3	-12,1	-9,4	17,1	-5,6	5,1	2,2	-1,2	3,3	-3,6	6,4	4,9	-7,5	#REF!
Kreditë e popullsisë*	9,7	6,3	6,2	4,5	4,7	5,7	4,0	3,2	-0,5	-5,6	-9,2	-9,3	-6,6	-2,4	0,0	#REF!
Paga mesatare neto*	10,0	4,6	7,0	4,7	2,0	5,7	1,1	0,7	0,0	-1,7	-4,6	-4,6	-2,8	3,6	6,6	-
Borxhi privat neto*	-2,0	-38,0	-34,9	-10,2	9,5	66,5	55,5	14,2	9,8	24,1	11,8	5,1	11,3	-8,4	-10,5	-
Pensione*	5,7	6,2	5,3	5,4	2,3	0,3	0,0	-1,8	-3,4	-1,0	-10,4	-4,9	-2,5	1,3	9,9	#REF!

*rritjet reale të rritjes llogariten nga BPRMV-ja, duke pjesëtuar normat nominale të rritjes me inflacionin vjetor, të matur sipas shpenzimeve të jetesës.

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, Ministria e Financave dhe llogaritjet e BPRMV-së.

KATEGORITË E INVESTIMEVE INDIKATIVE

	2020				2021				2022				2023			
	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	Tr.4	Tr.1	Tr.2	Tr.3	tet.
	ndryshime reale vjetore në %, përveç për SDI në miliona denarë															
Import i mjeteve për punë*	1,0	-34,5	-3,0	4,4	8,9	64,2	6,5	4,7	6,8	5,5	10,8	-1,4	-3,8	-1,9	-5,5	#REF!
Punimet e realizuara ndërtimore**	6,3	-5,1	3,0	2,3	-1,1	-9,6	-10,8	-17,5	-11,1	-1,2	-19,2	-14,0	14,7	-21,2	-8,4	-
Prodhim i brendshëm i produkteve kapitale	-5,7	-46,0	-9,0	1,0	-7,3	59,6	-24,3	-22,3	0,9	3,3	18,6	3,7	6,7	8,2	6,7	#REF!
Investime shtetërore kapitale*	23,8	-34,4	26,0	-20,7	166,5	3,7	56,2	9,3	-16,4	25,0	-47,4	55,6	-6,8	312,9	29,1	#REF!
Investime direkte***	4668,1	-2737,5	-6616,2	-10681,2	-10610,7	15231,4	1550,0	9560,3	8793,1	-5805,2	9715,3	239,9	592,0	-2571,4	-8512,4	-
Kredi afatgjatë të ndërmarrjeve*	4,1	8,2	11,5	5,8	7,3	2,5	0,7	3,9	2,2	-2,2	-6,5	-6,7	-5,0	1,2	3,4	#REF!
Inventari i produkteve të gatshme	9,0	15,7	2,6	-8,0	2,0	9,7	16,1	12,4	11,5	9,2	11,1	10,5	-3,1	-5,5	-9,9	-

*rritjet reale të rritjes llogariten nga BPRMV-ja, duke pjesëtuar normat nominale të rritjes me inflacionin vjetor, të matur sipas shpenzimeve të jetesës.

**rritjet reale të rritjes përfitohen duke përdorur normën e rritjes së deflatorit të shpenzimeve të ndërtimit të banesave të reja.

***shumat reale llogariten nga BPRMV-ja, duke pjesëtuar shumat nominale me nivelin e indeksit të çmimeve të konsumit (viti bazë: 2022= 100).

Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës, Ministria e Financave dhe llogaritjet e BPRMV-së.